

26.02.2021
Ora 17:32

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për miratimin e specifikimeve teknike të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- | | | |
|------------|-----------|--------------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | Y.Merkaj, N.Mezani |
| Parti | Politike: | LSI (A.Kaziaj) |

Znj.I.Nano: Përshëndetje të nderuar kolegë, nisim mbledhjen e Komisionit Rregullator. Në mbledhjen e sotme kemi një çështje në rendin e ditës, kemi shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e specifikimeve teknike të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”.

Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, është Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe zyrtarë të tjerë të administratës së KQZ-së. Nga partitë politike kemi vetëm përfaqësuesin e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, zotin Altin Kaziaj. Atëherë do të doja të fillonim pa vonesë me projektaktin, është një projektakt i rëndësishëm i cili vjen në kuadër të përmbushjes së detyrimeve nga ana e Komisionit Rregullator për të

28

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.26.02.2021*

miratuar aktet normative në fushën e zgjedhjeve. Në këtë rast kemi të bëjmë me një akt që lidhet me miratimin e specifikimeve teknike të fletës së votimit që do të përdoret në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill. Me shqyrtimin dhe miratimin e këtij akti nga ana jonë, i çelet rruga më tej administratës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të vijojë me procedurat për sigurimin e fletëve të votimit. Për të prezantuar në mënyrë të përmbledhur aktin dhe relacionin shoqërues të tij do t'i lutesha Sekretarit të Përgjithshëm zotit Merkaj të bënte një paraqitje të projektaktit, zoti Merkaj?!

Z.Y.Merkaj: Referuar nenit 97, paragrafi 1 dhe nenit 98 të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të miratojë specifikimet teknike të fletës së votimit, ndërsa përmbajtja e fletës së votimit miratohet pas përfundimit të afatit të regjistrimit të subjekteve zgjedhore. Fleta e Votimit duhet të ketë ngjyrë dhe formë të njëjtë për të gjitha zonat zgjedhore. Gjithashtu fleta e votimit duhet të jetë prej letre, me ngjyrë, trashësi dhe elemente konfigurimi të tilla që të mos lejojnë leximin e votës në pjesën e pasme të saj. Letra që do të përdoret për prodhimin e fletës së votimit, përmban disa elemente sigurie. Fleta e votimit do të përmbajë dhe disa elemente teknike në formën e kodeve që identifikojnë numrin serial, zonën zgjedhore dhe qendrën e votimit që nuk lexohen me sy të lirë (barkod). Elementet e sigurisë dhe elementet teknike janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar në lidhjen nr.1 dhe është pjesë integrale e këtij vendimi. Letra që është propozuar ka përmasat 297 mm me 420 mm në formatin A3 të cilat mund të ndryshojnë në varësi të listave shumëmeore për çdo zonë zgjedhore. Për sa më sipër, në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore, i propozon për shqyrtim dhe miratim Komisionit Rregullator projektvendimin, "Për miratimin e elementëve teknike të detyrueshëm që duhet

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*



të përmbajë fleta e votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021".

Znj.I.Nano: Zoti Merkaj, faleminderit. Atëherë të nderuar kolegë çelim diskutimin në parim lidhur me projektvendimin. Kush e do fjalën nga ju? Nëse ka diçka për të diskutuar në parim? Po zonja Vukaj.

Znj.H.Vukaj: Faleminderit zonja Nano, përshëndetje të ftuarve. Do doja të theksoja vetëm diçka, në parim akti është shqyrtuar dhe ne në parim e gjejmë dakord, pavarësisht se formalisht do të ndjekim rutinën procedurale. Por do doja të shprehja diçka në lidhje me aktin meqenëse ka pasur pritshmëri të madhe mediatike dhe nga publiku për hir të debatit të paraçelur në media qoftë nga forcat politike apo nga grupet e interesit. Akti i sotëm është shumë i rëndësishëm sepse çel siparin e prokurimit të fletës së votimit e cila në vazhdimësinë e saj dhe në elementët përmbajtësor do të jetë një akt i cili do të vij në vijim dhe që do të respektohen normalisht edhe kritere të tjera të kodit apo pritshmëri të tjera siç është lista shumemërore e cila ka dhe një afat. Në varësi të këtyre elementëve ne në vijim do të miratojmë aktin final i cili përbën dhe interesin më të madh të publikut apo të medias në këtë moment. Faleminderit zonja Nano, nuk kisha gjë tjetër.

Znj.I.Nano: Faleminderit zonja Vukaj, nëse ndonjë nga kolegët e tjerë dëshiron të shtojë diçka, apo të thotë diçka lidhur me projektaktin në parim, në vijim të asaj që tha zonja Vukaj?! Sigurisht ky është akti i parë në kuadër të disa akteve deri në miratimin e përmbajtjes të fletës së votimit. Sigurisht jemi në kushtet kur tashmë janë regjistruar subjektet zgjedhore dhe jemi në pritje të depozitimit pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të listave të kandidatëve sikundër edhe zonja Vukaj e tha të cilët do të ndikojnë edhe në madhësinë e fletës së votimit.



Është një proces i cili do të merret nga ana e Komisionit Rregullator në një të ardhme të afërt. Gjithsesi për këtë akt nëse kolegët apo përfaqësues të partive politike kanë diçka për të diskutuar në parim. Zoti Kaziaj ju?

Z.A.Kaziaj: Përshëndetje, nuk kemi asgjë në parim zonja Kryetare.

Znj.I.Nano: Dakord, ju falenderoj. Nëse nuk keni diçka tjetër për diskutimin në parim do të ftoja kolegët të kalojmë në votimin në parim të projektvendimit “Për miratimin e specifikimeve teknike të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”?

Kush është dakort me projektvendimin?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro miratohet në parim projektvendimi!

Kalojmë nen për nen, dukeqenëse është vetëm zoti Kaziaj nga përfaqësuesit e partive politike do t’i kërkoja që nëse ka diçka të marrë fjalën sipas pikave konkrete. Ka 4 pika ky vendim, Komisioni Rregullator vendosi:

1.Miratimin e specifikimeve teknike të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021, sipas Lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

Më lejoni të lexoj lidhjen 1 ku janë specifikimet teknike të cilat edhe në mënyrë të përmbledhur u thanë pak më herët nga Sekretari i Përgjithshëm. Për shkak se jemi në kushtet që do të duhet t’i votojmë më lejoni t’i lexoj të gjitha.

- Lloji i letrës:

Watermark 90gr/m² 100% pulp, me fibra karboni ultraviolet, 2 shtresa, me certifikatë origjine, i vazhdueshëm me skicë speciale, me mikroprintime, element në printim që shikohet me rreze ultraviolet. Zarfë me elementët e sigurisë dorëzohet i vulosur nga operatori ekonomik dhe depozitohet në KQZ.



- Dimensionet e fletës së votimit:

Gjerësia e fletës së votimit 297 mm.

Gjatësia e fletës së votimit 420 mm.

- Specifikime të përgjithshme:

Stema e Republikës, me ngjyra.

Logo KQZ, me ngjyra.

Barkodi (elementë teknik në formën e kodeve):

- Numri serial 7 shifra.

- Qarku 2 shifra.

- Numri i qendrës së votimit.

Kjo është Lidhja 1 bashkëlidhur këtij vendimi, pra që shoqëron pikën 1 të projektvendimit. Të nderuar kolegë dhe ju të partive politike nëse keni diçka përpara se të kalojmë për votim? Mesa shoh nuk ka ndonjë diskutim, atëherë ftoj anëtarët e Komisionit Rregullator të votojnë për pikën 1 sipas propozimit të ardhur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Kush është dakord me këtë propozim?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

2. Komisioni Rregullator, mund të ndryshojë përmasat e fletës së votimit, në varësi të listave shumemërore për çdo zonë zgjedhore.

Çelim diskutimin edhe për këtë pikë, në fakt unë pa rënë në përsëritje do të thoja që kjo pikë në projektvendim është parashikuar për t'i çelur rrugë mundësisë së ndryshimit të atyre përmasave të fletës së votimit që ne sapo i votuam pra, në formatin A3, 297 mm me 420 mm. Në varësi të listave shumemërore për çdo zonë zgjedhore që do të dorëzohen do të rivlerësohet edhe një herë nëse do të jetë nevoja, pikërisht ky element. Kolegë keni ndonjë çështje



për diskutim lidhur me këtë pikë? Nuk kemi, atëherë ju ftoj të votojmë pikën 2 sipas përmbajtjes së ardhur me propozim të Komisionerit.

Kush është dakord me pikën 2 të projektvendimit?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Pika 3 dhe pika 4 janë dispozita të zakonshme.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Kush është dakord me pikën 3?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord me pikën 4?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro miratohet!

Atëherë kemi votuar në parim, kemi votuar secilën prej pikave të projektvendimit, është momenti të votojmë projektvendimin në tërësi. Atëherë votojmë në tërësi projektvendimin "Për miratimin e specifikimeve teknike të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021", të nderuar kolegë, anëtarë të Komisionit Rregullator,

Kush është dakord në tërësi me projektvendimin?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka



33

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.26.02.2021*

Me 5 vota pro sapo kemi miratuar projektvendimin “Për miratimin e specifikimeve teknike të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”. Në rendin e ditës nuk kemi ndonjë çështje tjetër për të diskutuar, nëse kolegët kanë diçka janë të mirëpritur, nëse përfaqësuesi i Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim ka diçka jashtë rendit të ditës? Mesa shoh nuk kemi diskutime të tjera, atëherë më lejoni të mbyll mbledhjen e Komisionit Rregullator. Ju falenderoj për pjesëmarrjen në mbledhje, natën e mirë.

Vendimi nr. 6

*Zbardhi materialin audio
Jona DERVISHI*

7

